

UDHËZIM
Nr. 5, datë 28.2.2024

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE
TË NXËNËSVE NË ARSIMIN FILLOR, VITI SHKOLLOR 2023–2024**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor më datë 24 maj 2024, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.
2. Testi është i integruar dhe përfshin njohuri nga lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.
3. Për nxënësit e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase pjesa e testit që përfshin njohuri nga lëndët e matematikës dhe të dëturisë së natyrës të jetë në gjuhën e tyre amtare.
4. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, fillon në orën 10:00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.
5. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet vlerësimi.
6. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testit përcaktohen në rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor”, miratuar me urdhrin nr. 66, datë 13.2.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit
7. Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.
8. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe nevojat e tyre, sipas përcaktimeve të rregullores “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor”.
9. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.
10. Arkivimi i testeve bëhet pranë zyrave vendore të arsimit parauniversitar.
11. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, në DPAP dhe në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.
12. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu